

## Kur dëgjon rrahjet të thundrave, mendo për kuajtë, jo për zebrat

Në fushën mjekësore termi "zebra" nuk është një term formal, zyrtar si me thënë, por ai gjithsesi përdoret, sidomos në SHBA, për të treguar probabilitetin e vogël për një diagnozë të caktuar. Kur thonë "zebra" shpesh duan të thonë "sëmundje apo gjendje e rrallë", apo në mënyrë më të detajuar: një gjendje mjekësore, shfaqja e së cilës në një kohë dhe vend të caktuar, në një person të caktuar, është e papritur dhe surprizuese.

Termi vjen prej një thënie të vjetër të viteve 1940të nga Theodore Woodward, profesor në University of Maryland School of Medicine, që përdorej për t'u mësuar studentëve të mjekësisë se si të arsyetonin me logjikë në lidhje me diagnozën diferenciale. Pra si të mendonin kur një seri shenjash apo simptomash mund të shpjegohet nga 2 ose më shumë shkaqe/patologji të ndryshme.

*"Kur dëgjon rrahjet të thundrave, mendo për kuajtë, jo për zebrat."*

(Në Maryland, kuajtë janë relativisht të përhapur, ndërsa zebrat janë tejet të rralla, dhe logjikisht nëse dëgjon thundra që rrahin në shesh, duhet të mendosh se kafsha është një kal dhe jo një zebër. Natyrisht që ndonjëherë këto rrahje thundrash do të jenë prej zebrave, ekzotike, të rralla, por këto janë raste të veçanta, që gjithsesi duhen mbajtur "shënim" në një cep të mendjes.)

Me fjalë të tjera shikoni për diagnozën më të shpeshtë dhe të zakonshme, dhe jo për diagnozën me ekzotike apo surprizuese e të rrallë. Për shembull, kur një pacient zhvillon një kollë, shkaku më me gjasa dhe më logjik që duhet menduar është një infeksion viral, dhe jo një tuberkulozë. Natyrisht tuberkuloza duhet mbajtur në mendje dhe i duhet hequr vizë vetëm pasi të jetë konfirmuar plotësisht diagnoza tjetër ose të kemi të dhëna për të mos menduar më për tuberkulozën, pra që e kontradiktojnë atë arsyetim.

-

© Rinstinkt blog